



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. F301 Prot.  
1

Tiranë, më 06.03 2024

VENDIM

Nr. 19 dt. 06.03 2024

“PËR

**SHTYRJEN E AFATIT TË THIRRJES PËR APLIKIMIN PËR PRANIMIN NË CIKLIN  
E TRETË TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË ‘SHKENCA SPORTIVE’ DHE  
“AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI” PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Mbështetur në nenet 35, 38, 77, paragrafi 4, 78 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Udhëzimin e MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 64 të Rregullores së UST-së, në nenet 13,14,15 të Rregullores për Organizimin e Programeve të Studimit të Ciklit të Tretë “Doktoratë” në UST, e ndryshuar, Urdhërit të Rektorit nr.5, datë 06.02.2024, Senati Akademik në datën 06.03.2024,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të thirrjes për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” për vitin akademik 2023-2024 në programet “Shkenca Sportive” dhe “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” deri në datë 08.04.2024
2. Ky Vendim i përcillet Rektorit të UST-së për nxjerrjen e urdhërit përkatës.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim FSHL-së, FVFR-së si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA

